

VENDIM
Nr. 682, datë 14.11.2018

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E DREJTËSISË, PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BURGJEVE, TË PRONËS NR. 104, ME EMËRTIM “REPARTI USHTARAK NR. 4003”, ME VENDNDODHJE TE RRAPI I TRESHIT, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Drejtësisë, për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, të pronës nr. 104, me emërtim “Reparti ushtarak nr. 4003”, me vendndodhje te Rrapi i Treshit, Tiranë, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për plotësimin e nevojave institucionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, të hiqet prona nr. 104, me emërtim “Reparti ushtarak nr. 4003”, me vendndodhje te Rrapi i Treshit, Tiranë, dhe të shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kanë kaluar në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Drejtësisë, për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

3. Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve u ndalohej të ndryshojnë destinacionin e përdorimit të pronës të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojnë ose t’ua japin atë në përdorim të tretëve.

4. Për ruajtjen dhe sigurinë e pronës nr. 1335, me emërtim “Qendra Zhvillimore e Fëmijëve Autikë”, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, që ndodhet në kufi me pronën nr. 104, me emërtim “Reparti ushtarak nr. 4003”, me vendndodhje te Rrapi i Treshit, Tiranë, të cilat janë brenda të njëjtit rrethim, për mënyrën e zbatimit të rregullave të hyrje-daljeve të personelit të strukturave ushtarake, të përdorimit e të mirëmbajtjes së rrjeteve inxhinierike, të linjave të komunikimit elektronik dhe të furnizimit me ujë, energji elektrike e të tjera linja, që janë në përdorim të përbashkët, të hartohet aktmarrëveshje ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë, të përfaqësuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave Armatosura, të përfaqësuar nga Komanda Mbështetëse dhe Batalioni i Mbështetjes i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

5. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Drejtësisë, drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Pronave të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

